

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**

**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

**DEPARTAMENTI- BIOTEKNOLOGJI NË ZOOTEKNI**



# **PUNIM DIPLOME**

**STUDIMET POSTDIPLOMIKE – MASTER**

Mentori:

Prof.Dr. Hajrip **MEHMETI**

Kandidati:

Valon **ISMAJLI**

*Prishtinë, 2021*

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**

**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

**DEPARTAMENTI: BIOTEKNOLOGJI NË ZOOTEKNI**



**PUNIM DIPLOME**

**STUDIMET POSTDIPLOMIKE – MASTER**

Tema:

**MAJMËRIA E QENGJAVE SHARR X VIRTEMBERG TË GJENERATËS F-2 PAS  
FAZËS SË MËMËZIMIT (3-6 MUAJ)**

Mentori:

Prof.Dr. Hajrip **MEHMETI**

Kandidati:

Valon **ISMAJLI**

## DEKLARATË

Unë, studenti Valon Ismajli deklaroj se:

Ky punim i diplomës përfaqëson punën time origjinale, përveç rasteve të citimeve dhe referencave.

Ky punim nuk është përdorur më parë si punim apo projekt në këtë Universitet apo Universitetet tjera.

Kandidati: Valon Ismajli

## **FALENDERIMET**

Shpreh falenderimin dhe mirënjohjen time të sinqertë për mentorin tim Prof.Dr. Hajrip Mehmetin për besimin dhe mbështetjen e vazhdueshme në punimin tim shkencor dhe shkrimin e temës së diplomës, për motivimin dhe seriozitetin e treguar gjatë realizimit të këtij punimi. Mbështetja e tij ka qenë esenciale në realizimin e këtij punimi.

Falenderoj Organizatën qeveritare Turke TIKA e cila e mbështeti projektin tonë duke iu dhuruar fermerëve desh Virtemberg për kryqëzim(ndërzim) me qëllim të përmirimit gjenetik të deles tonë(deles së Sharrit) si dhe mbështetjen financiare të studentëve hulumtues të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë me koordinatorin e projektit Prof.Dr.Hajrip Mehmeti.

Falënderoj Departamentin Bioteknologji në Zootekni për kushtet e ofruara gjatë studimeve dhe gjithashtu u jam mirënjohës profesorëve dhe stafit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë.

Një falënderim i madh është për familjen time e cila më ka mbështetur dhe përkrahur gjatë gjithë studimeve.

**Përmbajtja:**

<b>DEKLARATË</b> .....	2
<b>FALENDERIMET</b> .....	3
<b>ABSTRAKT</b> .....	5
<b>1. HYRJE</b> .....	9
<b>2. TË DHËNAT NGA LITERATURA</b> .....	12
<b>2.1. Karakteristikat Zooteknike dhe Prodhimtaria e Deles autoktone të Sharrit</b> .....	12
<b>2.2 Karakteristikat e racës Virtemberg-Merinosi Gjerman</b> .....	13
<b>2.2.1 Përshkrimi i racës Virtemberg të importuar në Kosovë</b> .....	14
<b>2.3 Karakteristikat Zooteknike,Fenotipore dhe Prodhuese tek racat e deleve të tjera autoktone të Kosovës</b> .....	16
<b>2.4 Parametrat Prodhues dhe Riprodhues të metisëve Sharr x Virtemberg (gjenerata F-1)</b> .....	19
<b>2.5 Prodhimtaria e mishit</b> .....	20
<b>2.5.1 Përbërja kimike e mishit</b> .....	21
<b>2.6 Roli i kullosave dhe livadheve në mbarështimin ekstensiv(kullosor)</b> .....	22
<b>3. QËLLIMI I HULUMTIMIT</b> .....	23
<b>4. MATERIALI DHE METODAT E PUNËS</b> .....	25
<b>4.1 Materiali</b> .....	25
<b>4.2 Metodat e Punës</b> .....	28
<b>5. REZULTATET</b> .....	29
<b>5.1 Rezultatet e therrjes së qengjave</b> .....	36
<b>6. DISKUTIMET</b> .....	38
<b>7. PËRFUNDIMET</b> .....	40
<b>8. REFERENCAT</b> .....	42

## ABSTRAKT

**Prezantimi-ky** studim ka për qëllim të siguroj informacione se si ndikon kryqëzimi i deles metis Sharr x Virtemberg (F-1) me merinosin gjerman të racës Virtemberg i drejtimit të prodhimitarisë mish-lesh në rritjen e masës trupore të qengjave metisë Sharr X Virtemberg (F-2) në mbarështimin ekstensiv(kullosor) pas fazës së mëmëzimit(3-6 muaj).Hulumtimi është kryer në fshatrat e komunës së Dragashit në vitin 2019 dhe është bërë krahasimi me shtimin e masës trupore të qengjave F-1 të hulumtuar nga autorë të tjerë.

Procedurës së hulumtimit për shtimin e masës trupore të qengjave Sharr x Virtemberg (F2) i ka paraprirë kryqëzimi i deles metis Sharr x Virtemberg(F1) me Merinosin Gjerman Virtemberg duke dhënë gjeneratën F-2.

**Qëllimi-** Hulumtimi është realizuar me qëllim që të kemi informacione se si ndikon gjenetika në shtimin e masës trupore te qengjat Sharr x Virtemberg gjenerata F-2 në kushtet kur mbarështimi është në kushte ekstensive(kollusore).Qengjat e gjeneratës F-2 kanë treguar potencial më të lartë të shtimit të masës trupore në krahasim me qengjat F-1 të hulumtuar nga autorë të tjerë duke ndikuar në prodhimin më të lartë të mishit të qengjit.

Gjatë këtij hulumtimi është realizuar procesi i matjes në ditë të caktuara,therrjes së qengjave(180 ditësh),peshimi i indeve,peshimi i organeve) me qëllim të përcaktimit të rrezes së mishit.Në bazë të rezultateve qengjat meshkuj kanë potencial gjenetik më të lartë në shtimin e masës trupore ndërsa qengjat femra dhe binjakë(meshkuj ose femra) kanë potencial më të ulët të shtimit të masës trupore.

**Materiali dhe Metodat-** Si material për hulumtim kanë shërbyer kopetë e deleve të Vëllezërve Kollani,Emin Kollanit,Xhezahir Kollanit, Rrahim Kollanit nga fshati Kosavë,komuna e Dragashit të cilët i mbarshtonin bashkë kopetë e tyre dhe Fermeri Shukri Myrtezani nga fshati Zapllugjë,komuna e Dragashit.

Të dhënat u përpunuan duke përdorur Programin Microsoft Excel.Për kërkim të literaturës janë përdoruar databazat më relevante si : GoogleScholar etj.

**Rezultatet-** Për realizimin e hulumtimit të masës trupore e kemi përdorur peshoren digjitale dhe në disa raste edhe atë mekanike duke i matur qengjat në ditë të caktuara. Në hulumtim janë përfshirë qengja meshkuj, qengja femra dhe qengja binjakë (meshkuj dhe femra) të cilët masën trupore e kanë pasur të ndryshme.

Në bazë të rezultateve të matjeve qengjat meshkuj kanë shtim më të madh të masës trupore, qengjat femra shtim më të ulët dhe në rastet kur lindja ka qenë me binjakë, qengjat kanë pasur shtim edhe më të ulët.

**Përfundimet-** Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimeve, qëllimi i të cilave ka qenë që të hulumtohet masa trupore e qengjave Sharr x Virtemberg (F-2) pas fazës së mëmëzimit (3-6 muaj), vlera e karkasës ku janë peshuar organet dhe indet e kafshëve të therura dhe është gjetur raporti në mes të indit muskolor, indit dhjamor, indit ashtëror, ku përfundimet janë duke u bazuar në rezultatet e hulumtimeve qëllimi i të cilave ka qenë që të hulumtohet masa trupore e qengjave Sharr x Virtemberg gjenerata F-2 pas fazës së mëmëzimit (3-6 muaj), vlera e karkasës ku janë peshuar organet dhe indet e kafshëve të therura dhe është gjetur raporti në mes të indit muskolor, indit dhjamor, indit ashtëror dhe konkluzionet janë që qengjat meshkuj Sharr x Virtemberg (F-2) në kushtet ku mbarështimi është bërë në kushte kullosore (ekstensive) kanë treguar shtim më të madh trupor në krahasim me qengjat femra dhe ata binjakë (meshkuj ose femra).

## ABSTRACT

**Presentation**-this study aims to provide information on how the crossbreeding of Sharr x Wirtemberg (F-1) breed sheep with the German merit of the Wirtemberg breed of meat production direction increases the body mass of Sharr X Virtembeg breed lambs ( F-2) in extensive breeding (pasture) after the laying phase (3-6 months).

The research was conducted in the villages of the municipality of Dragash in 2019 and was compared with the increase in body mass of F-1 lambs researched by other authors.

The research procedure for increasing the body mass of Sharr x Virtemberg (F2) lambs was preceded by the crossing of the Sharr x Virtemberg (F1) metis sheep with the German Merinos Wirtemberg giving the F-2 generation.

**Purpose**- The research was conducted in order to have information on how genetics affects the increase in body mass of Sharr x Wyrtemberg lamb generation F2 in conditions when breeding is in pasture conditions.

F2 lambs have shown higher potential for body mass gain compared to F1 lambs researched by other authors influencing higher lamb meat production.

During this research, the process of measuring on certain days, slaughtering lambs, weight of tissue, organs) was carried out in order to determine the radius of the meat.

Based on the results, male lambs have a higher genetic potential for weight gain, while female and twin lambs (male or female) have a lower potential for weight gain.

**Material and Methods**- The sheep herds of the Kollani Brothers, Emin Kollani, Xhezahir Kollani, Rrahim Kollani from the village of Kosava, the municipality of Dragash / Dragaonin who served their herds together and the farmer Shukri Myrtezani from the village of Zapllugjë, munipacility of Dragash.

Data were processed using Microsoft Excel Program.

The most relevant databases such as: GoogleScholar etc. have been used for literature search.



**Results** - For the realization of the research of the body mass we have used the digital scale and in some cases also the mechanical one by measuring the lambs on certain days.

The study included male lambs, female lambs and twin lambs (male and female) who had different body mass. Based on the measurement results, male lambs have higher body weight, female lambs have lower and in cases when the birth was with twins, they had even lower growth.

**Conclusions**- Based on the results of research, the purpose of which was to investigate the body mass of Sharr x Wirtemberg lambs (F-2) after the laying phase (3-6 months), the value of the carcass where the organs and tissues of slaughtered animals and found the relationship between muscle tissue, adipose tissue, bone tissue, where the conclusions are based on the results of research, the purpose of which was to investigate the body mass of Sharr x Wirtemberg (F-2) lambs after lactation phase (3-6 months), carcass value where the organs and tissues of slaughtered animals were weighed and the ratio between muscle tissue, adipose tissue, bone tissue was found and the conclusions are that male lambs Sharr x Wyrtemberg (F-2) in conditions where breeding was done in pasture conditions have shown greater body growth compared to female lambs and twins (male or female).

## 1. HYRJE

**Blegtoria** është degë e rëndësishme e bujqësisë e cila bazohet në mbarështimin e kafshëve shtëpiake me qëllim që të fitohen të mira materiale për të ushqyerit e njerëzve. Zhvillimi i prodhimitarisë blegtorale siguron bazën themelore për të rritur kapacitetet e prodhimit dhe përpunimit të produkteve si qumështi, leshi, mishi, vezët, nënproduktet e tyre të cilat janë me vlera të larta ushqyese duke i dhënë blegtorisë një rëndësi të madhe në zingjirin ushqimor.

**Dhentaria** si disiplinë e blegtorisë ka për qëllim prodhimin e produkteve blegtorale me vlera të larta ushqyese si mishi dhe qumështi për të ushqyerit e popullsisë, prodhimin e leshit i cili është i rëndësishëm në industrinë e tekstilit si dhe plehun e stallës për plehërimin e tokave bujqësore.

Delja hyn në grupin e ripërtypësve i cili ka sistem të tretjes që e shfrytëzon shumë mirë ushqimin që përmban fibra dhe e konverton atë në ind muskolor (mish), qumësht etj.

Gjenetika ka rëndësi të madhe në progresin ekonomik të dhentarisë sidomos në rendimentin më të madh të produkteve blegtorale nga mbarështimi i drejtë i tyre.


Me qëllim të zhvillimit të blegtorisë duhet që mbarështimi i kafshëve të monitorohet nga njerëzit profesionist në punët si kryqëzimi, seleksionimi, ushqyerja etj. me qëllim që profiti i fermës të jetë sa më i madh.

Kryqëzimi i deles së Sharrit me merinosin Gjerman Virtembergun ka dhënë rezultate të shkëlqyeshme duke e rritur prodhimin e mishit dhe duke e përmirësuar cilësinë e fijeve të leshit.

Në Kosovë kërkesat për mish të deleve më të mëdha janë me qëllim të therrjes për Kurban në Festën e Kurban Bajramit (festë e Myslimanëve) dhe nga restaurantet të cilat ofrojnë mish qengji për klientët e tyre.

Numri i deleve ka ndryshuar me kalimin e viteve dhe sipas publikimeve të Anketës Bujqësore (2018) numri i deleve sipas kategorisë është 181,105 krerë në të cilën delet qumështore marrin pjesë me 120,599 krerë, të mbarësuar për herë të parë (rrunëza) 18,713 krerë, qengja deri 6 muaj 28,179 krerë, qengja mbi 6 muaj 9,473 krerë, desh për riprodhim 4,141 krerë.

Sipas Anketës Bujqësore në vitin 2019 numri i deleve sipas kategorisë është 189,102 krerë në të cilën delet qumështore marrin pjesë me 125,222 krerë, të mbarësuara për herë të parë (Rrunëza) 20,026 krerë, qengja deri në 6 muaj 30,079 krerë, qengja mbi 6 muaj 9,513 krerë, desh për riprodhim 4,262 krerë.



**Grafiku 1. Numri i deleve gjatë vitit 2005-2019 (anketa e ekonomive bujqësore)**


Sipas publikimeve të llogaritjes ekonomike bujqësore (2018) në produktet blegtorale marrin pjesë delet dhe prodhimi i deleve i cili për nga rëndësia radhitet menjëherë pas gjedheve. Prodhimet blegtorale arrin vlerën 271.8 milion euro.

Prodhimtaria e deleve dhe dhive si aktivitet bujqësor që kryesisht zhvillohet në zonat e thella rurale është aktivitet i orientuar në prodhimtari të mishit.

Në vitin 2018 prodhimi i mishit të deleve dhe dhive vlerësohet të jetë rreth 2,116 tonë në peshë të therur, importi në krahasim me prodhimtarinë vendore është shumë i ulët dhe Kosova arrin t'i plotësoj nevojat vendore për konsum rreth 99%. Vlera e prodhimit në vitin 2018 është 5.2 mil. €. Konsumi për kokë banori llogaritet të jetë rreth 1.2 kg/vit.

Sipas Anketës së ekonomive bujqësore 2019 fondi blegtoral i Kosovës është si vijon:Gjedhe 257,733 krerë,Dele 189,102 krerë,Dhi 27,197 krerë,Derra 40,538 krerë, Njëthundrakët(kuajt) 2,037 krerë,shpezët 2,665,262 krerë, Koshere të bletëve 219,831.

Numrin e kafshëve që bëjnë pjesë në fondin blegtoral për vitin 2019 e kemi paraqitur në përqindje në grafikun 2 (anketa e ekonomive bujqësore 2019).



**Grafiku 2. Pjesëmarrja e kafshëve sipas Anketës së ekonomive bujqësore 2019**

## 2. TË DHËNAT NGA LITERATURA

### 2.1. Karakteristikat Zooteknike dhe Prodhimtaria e Deles autoktone të Sharrit

Delja e Sharrit është dele autoktone e Kosovës dhe bënë pjesë në grupin e xhufkave.

Fjala xhufkë nënkupton një dele autoktone e cila për vite me radhë është mbarshuar për qëllime të trefishta (qumësht-mish-lesh).

Delja e Sharrit është përshtatur mirë në kushtet natyrore, aftësinë e kullotjes dhe me klimat e ftohta malore. Regjioni i mbarështimit për këto dele janë kryesisht Malet e Sharrit në pjesën jugore të Kosovës prej nga buron emri. Kjo racë mbarështohet edhe në shtetin fqinjë në Maqedoninë e Veriut.

Sa i përket madhësisë së trupit delja e Sharrit është një nga racat më të vogla në Kosovë. Masa trupore e deleve të maturuara është 35 kg ndërsa deshët e maturuar 45 kg. Lartësia mesatare në xhidavi për delet e maturuara është rreth 57.4 cm. Pjelloria është e ulët 102%. Qengjat në lindje kanë masë trupore 2.5-3.5 kg, ndërsa në shkëputje (3 muajsh) 18-22 kg. Delet e Sharrit kanë një ngjyrë të bardhë të leshit, fytyrës dhe këmbëve. Prodhimtaria e leshit arrin 0.9-2.0 kg. Diametri i fijes është 37  $\mu\text{m}$  (Bytyqi dhe Mehmeti, 2006). Deshët kanë brirë ndërsa delet janë shyte. Prodhimtaria e qumështit është rreth 92.60 kg në laktacionin prej 199 ditëve, me prodhimtari mesatare ditore 465g dhe me 5.5% yndyrë. Leshi i deleve tona sipas lehmanit hyn në asortmanin DE (37-60 mikrometra).



Figura 1. Dashi i Sharrit



Figura 2. Delja e Sharrit

## 2.2 Karakteristikat e racës Virtemberg-Merinosi Gjerman

Raca Virtemberg karakterizohet me konstitucion të fortë dhe trup mirë të formuar. Është e aftë për ecje të gjatë në viset kodrinoro-malore dhe mjaft mirë aklimatizohet në kushte të reja të mbarështimit.

Virtembergu është racë e drejtimit për mish dhe lesh, me lartësi të xhidavisë 80 cm te deshët dhe 70 cm tek delet. Masa trupore sipas standardeve të racës tek deshët është 120-160 kg, ndërsa te delet është 75-90 kg, me rreze të mishit 50-55%.

Leshi është me ngjyrë të bardhë përveq kokës dhe pjesëve të poshtme të këmbëve të cilat janë pa lesh. Prodhimtaria vjetore e leshit tek deshët është 6.5-7 kg dhe 4-5kg tek delet, me rreze 50-55%. Bashka është e tipit të mbyllur dhe me diametër të fijes së leshit 24-26 mikron. Virtembergu e ka aftësinë mirë të shprehur për prodhimin e qumështiit e cila arrin të prodhoj deri 150 kg qumësht gjatë laktacionit dhe ka pjellori 160%.



**Figura 3. Virtembergu në Kullosë**



**Figura 4. Raca Virtemberg**

### 2.2.1 Përshkrimi i racës Virtemberg të importuar në Kosovë

Virtembergu është merinos gjerman i drejtimit mish-lesh i cili në Kosovë u importua për herë të parë në vitin 1980(100 desh dhe 500 dele) në kooperativën bujqësore të quajtur "Prodhimet e Sharrit"ku përmirësimi gjenetik i deles së Sharrit ishte i shkëlqyeshëm dhe së fundi në vitin 2018 u importuan 90 krerë desh Virtemberg nga Gjermania në Kosovë përmes organizatës qeveritare turke "TIKA" me qëllim të përmirësimit racor të deleve leshshkurtra autoktone të Kosovës.

Deshët e importuar kanë qenë të kategorisë rrunëzak të moshës 18-20 muajsh,lartësia mesatare e xhidavisë është mesatarja 84.95 cm,gjatësia e trupit 103.1cm dhe masa e gjallë 84.85 kg.

Deshët e importuar nuk janë të njëjtë me parametrat e standardeve të racës për arsye se janë të kategorisë rrunëzak që nënkupton që ende nuk e kanë përfunduar rritjen.

Shpërndarja e deshëve është bërë tek fermerët që mbarështojnë mbi 100 krerë dele dhe është bërë kryqëzim meliorativ që nënkupton përmirësimin e tipareve sasiore të mishit dhe asaj cilësore duke rritur cilësinë e leshit.

Për rëndësinë e kryqëzimeve në mes të racave autor të ndryshëm kanë bërë hulumtime dhe kanë përfundime të ndryshme.

Autori Rako et al. (1982) konkludoi se në majmërinë krahasuese të qengjave Pramenka dhe Pramenka x Virtemberg në 90 ditë kryqet treguan epërsi përse i përket tipareve të therjes, duke marrë parasysh që ata kishin arritur rendimentin e mishit prej 59.08% në krahasim me rendimentin e qengjave Pramenka prej 56.66%,ndërsa Mitic(1984) konstatoi se analiza e sistemeve të mbarështimit të deleve në botë tregon se në shumë vende qengjat e therjes janë kryqe në 30-70% të rasteve.

Autori Lawrie( 1988) konstaton se mishi nga qengjat e gjirit është më i dobët se ai i qengjave të shkëputur për shkak të përqendrimit të ulët të hekurit në qumështin e deles.Rritja e pigmentimit në mish nga qengjat e shkëputur janë për shkak të një përmbajtje më të lartë të hekurit në racione të pasura me foragjere dhe koncentre. Muskujt e qengjave të cilët ecin gjatë për të kullosur janë më të errët për shkak të kërkesës më të madhe për oksigjen për lëshimin e energjisë në muskul.

Sipas Petrovic (2000) fenomeni i heterozigocitetit është aktivitet më i lartë dhe stabilitet i proceseve biokimike që karakterizojnë kryqet, gjë që çon në një shprehje më të mirë të disa tipareve sasiore (pjellorinë, rritjen, shfrytëzimin e ushqimit) në gjeneratën F-1 të kryqëzuar në krahasim me prindërit.

Autori Ugarte( 2007) konstaton se për një menaxhim të suksesshëm të mbarëtimit të deleve duhet të kemi një program të shumimit dhe të dimë se cilët faktorë ndikojnë në prodhim.

Sipas Leymaster (2002),Petrovic et al.(2011) Bërja e kryqëzimit është mënyra më efektive për të përmirësuar prodhimin e mishit të qengjit, sepse ndikon drejtpërdrejt në rritjen e peshës trupore të qengjave.

Kuchtik et al. (2012) konkludoi se duke marrë parasysh që mënyra më e shpejtë dhe e lehtë për të përmirësuar performancën e rritjes dhe cilësinë e karkasave është kryqëzimi.



### **2.3 Karakteristikat Zooteknike, Fenotipore dhe Prodhuese tek racat e deleve të tjera autoktone të Kosovës**

Struktura e deleve në Kosovë kryesisht përbëhet nga racat autoktone të cilat mbarështohen për tre qëllime (qumësht-mish-lesh) të cilat kanë madhësi trupore dhe kapacitete prodhuese të ndryshme, d.m.th Bardhoka (BAR), Balusha (BAL), Delja e Sharrit (SHA), Delja e Kosovës (KOS) dhe Metisët (Sharr x Virtemberg).

Për shkak të një prodhimi më të gjatë delet Bardhoka dhe Balusha prodhojnë më shumë qumësht në laktacionin e tyre të parë (174 dhe 135 kg) krahasuar me delen e Kosovës dhe delen e Sharrit (82 dhe 80 kg).

Në ditët e sotme dihet mirë që kafshët e përshtatura më së miri me mjedisin e tyre, tregojnë performancën më të mirë të karakterit të përgjithshëm (p.sh. mbijetesë, prodhimi, riprodhimi, etj). (Dillon et al., 2003; Hayes et al. 2003; Bytyqi et al. 2005).

Kosova edhe pse është një shtet i vogël, shumica e racave të deleve që kanë origjinën në rajone të ndryshme performojnë shumë ndryshe dhe kanë kaluar në fokus të larmishëm seleksionimi.

Kosova ka një traditë të gjatë në mbarështimin e deleve, por si sektorët e tjerë të ekonomisë së Kosovës ajo ka pësuar një periudhë rënie (sidomos gjatë periudhës së luftës 1999).

Të gjitha racat e deleve në Kosovë janë klasifikuar në grupin bishtgjata dhe hyn në grupin e racave me prodhimtari të trefishtë, qumësht-mish-lesh (Bytyqi dhe Mehmeti, 2006).

Qengjat dhe delet zakonisht shiten si kafshë të gjalla dhe deri më tani nuk është krijuar ndonjë produkt specifik për të rritur vlerën e mishit të deles. Qmimi për djathin varion nga 5 në 6 € / kg.

Kryesisht, qengjat shiten në një moshë prej rreth 150 ditësh, në kohën e pranverës përpara periudhës së kullotjes malore kurse qmimi varion nga 3 deri në 4 € / kg masë e gjallë.


Kafshët e maturuara (delet dhe deshët) shiten me çmim rreth 2.5 € / kg masë e gjallë.

**DELJA BARDHOKA**-Për shekuj me radhë kjo racë delesh është mbarështuar në Jugperëndim të Kosovës.

Emri rrjedh nga fjala (gjuha shqipe) "Bardhë-White", pasi ngjyra e kësaj deleje është plotësisht e bardhë. Delet Bardhoka mbahen për qëllime të trefishta, qumësht -mish- lesh. Përmes rritjes natyrore dhe selektive, kjo racë delesh u bë një nga delet më prodhuese për qumësht në mesin e deleve bishtgjata në Gadishullin Ballkanik (Cinkulov et al., 2008; Bytyqi, 2009). Kjo dele prodhon 100L qumësht për 6 muaj dhe ka pjellori 105%. Lartësia në xhidavi tek delet e maturuara është mesatare 64 cm, masa e bashkës është 2.5-3 kg ndërsa diametri i fijos së leshit është 42.5  $\mu\text{m}$  (Mehmeti et al., 2007). Dëshët kanë brirë ndërsa delet janë pa brirë.



**Figura 5. Delja Bardhoka**



**Figura 6. Dashi Bardhoka**

**DELJA BALUSHA**- Zona në të cilën këto dele mbarështohen është gjithashtu në pjesën jug-perëndimore të Kosovës që ndan të njëjtin rajon me racën Bardhoka. Emri rrjedh nga fjala Balush që d.m.th me njolla. Kjo dele është përshtatur mirë me aftësitë e kullotjes natyrore dhe mjeljes së lehtë. Balusha është mbarështuar si dele me qëllime të trefishta (qumësht-mish-lesh). Lartësia në xhidavi është mesatarisht rreth 65 cm. Delet Balusha kanë kokë të zezë, ngjyrë të bardhë të qimeve dhe këmbë me ngjyrë të bardhë. Masa e bashkës tek femrat dhe meshkujt është 2-2.5 kg dhe 3-3.5 kg. Diametri i fijos së leshit është 43  $\mu\text{m}$ .



**Figura 7. Deshët Balusha**



**Figura 8. Delet Balusha në fermë**

**DELJA E KOSOVËS-** Emri i kësaj Dele vjen nga vendi ku e ka origjinën kjo dele-Kosova. Kjo dele ka avantazhe në kushte të vështira natyrore dhe aftësi të kullotjes. Delet e Kosovës karakterizohen me qëllim të trefishtë qumësht - mish-lesh. Bishti është i gjatë, ngjyra e kokës dhe këmbëve është e zezë, ndërsa qimet janë me ngjyrë të bardhë. Masa e bashkës tek deshët dhe delet është mesatarisht 1.5–2.5 dhe 2.5–3.5 kg. Diametri mesatar i fijos është 37  $\mu\text{m}$  (Bytyqi dhe Mehmeti, 2006). Deshët janë me brirë ndërsa femrat shyte. Lartësia në xhidavi është rreth 62 cm.



**Figura 9. Delja e Kosovës**



**Figura 10. Delja e Kosovës**

## **2.4 Parametrat Prodhues dhe Riprodhues të metisëve Sharr x Virtemberg (gjenerata F-1)**

Autorë të ndryshëm që në hulumtimet e tyre studiuuan racën Virtemberg dhe e kryqëzuan me dele si meliorues ka dhënë rezultate të mira dhe njëri prej autorëve hulumtoi tiparet që i përmirson në kryqëzim me raca me tipare gjenetike më të dobëta ku ai hulumtoi për shtimin e masës trupore të metisëve Sharr x Virtemberg të gjeneratës F-1 tek qengjat meshkuj, femra dhe binjak të kategorisë pas fazës së mëmëzimit (pas shkëputjes nga gjiri) në mbarështim ekstensiv konkludoi se kryqëzimi është në dobi të sasisë së mishit dhe cilësisë së leshit dhe metisët e fituar përshtaten me kushtet e klimatike të Kosovës ku ai mori këto rezultate:

Masa trupore mesatare e qengjave meshkuj Sharr x Virtemberg, gjenerata F-1 (n=15) në moshën 90 ditë është 23.8 kg, në moshën 120 ditë është 31.5 kg, në moshën 150 ditë është 40.2 kg,

Masa trupore mesatare e qengjave femra Sharr x Virtemberg, gjenerata F-1 (n=13) në moshën 90 ditë është 21.73 kg, në moshën 120 ditë është 27.9 kg, në moshën 150 ditë është 34.52 kg,

Masa trupore mesatare e qengjave binjakë Sharr x Virtemberg, gjenerata F-1 (n=22) në moshën 90 ditë është 19.09 kg, në moshën 120 ditë është 22.6 kg, në moshën 150 ditë është 33.54 kg.

## 2.5 Prodhimtaria e mishit

Mishi paraqet prodhimin primar të deleve me rëndësi të madhe në të ushqyerit e popullatës. Mishi sipas Codex Alimentarius përkufizohet si "Të gjitha pjesët e një kafshe që janë të destinuara ose janë gjykuar si të sigurta dhe të përshtatshme për konsum njerëzor".

Mishi përbëhet nga uji, proteina dhe aminoacide, minerale, yndyrna dhe acide yndyrore, vitamina dhe sasi të vogla të karbohidrateve.

Delet për therje sipas moshës rangohen në këto kategori:

**I.** Qengjat që thithin.

**II.** Qengjat e shkëputur(hyjnë qengjat e të dy gjinive(3-6 muaj) që ende si kanë dhëmbët prerës sipas kualitetit rangohen në 1,2,3, klasë. Klasa e parë ka rreze të mishit 54% e klasa e tretë 48%.

**III.** Rrunëzat dhe Rrunzakët(mbi 6 muaj).

**IV.** Delet e Dëshët (mbi 1 vit).

Me mish qengji që thithin kuptojmë mishin e qengjave 3 javë deri në 3 muaj masa e trupit me kokën dhe me organet e brendshme me veshka, me yndyrë, me pëlthurëz të barkut, pa lëkurë dhe pa pjesët e poshtme të këmbëve duhet të peshoj 5 - 15 kg.

Me mish qengji të shkëputur kuptojmë mishin e qengjit 3 - 9 muaj me masë 6 - 25 kg, i përshkruar si i pari. Me mish delesh dhe të dashit kuptojmë mishin me masë të therur më së paku 15 kg.

Sa i përket kategorizimit në vetë trupin e therur i kemi 3 kategori:

**I** - Mishi i kafshës pa gjurin dhe i ijeve ( me veshkë dhe dhjamin veshkor )

**II** - Shpina , shpatullat dhe qafa

**III** - Gjoksi, barku dhe gjuri

### 2.5.1 Përbërja kimike e mishit

Në variabilitetin e përbërjes kimike të mishit ( në kuptim të gjerë ) ndikon numër i madh faktorësh:

Lloji i kafshëve ( delja ), tipi dhe raca, moshja, gjinia, niveli i të ushqyerit etj.

**PROTEINAT** - Vlera ushqyese e proteinave është e ndryshueshme. Përbajtja esenciale e aminoacideve cakton vlerën biologjike të proteinave ( Hofmani me bashkëpunëtor në vitin 1981 ). Në këtë pikëpamje proteinat e indit muskolor të cilat në përbajtjen e vet kanë aminoacide esenciale kanë vlerë mjaft të lartë biologjike. Për shkak të përbajtjes së vogël të aminoacideve esenciale në indin lidhor (në gjak) edhe vlera biologjike e këtij indit është 3 herë më e vogël se vlera biologjike e indit muskolor.

**LIPIDET** - Lipidet pas proteinave paraqesin komponentën kryesore të mishit. Në mish ndahen si intramuskulare dhe ekstramuskulare. Intramuskularet dallohen nga ekstramuskularet sepse të parat përmbajnë më shumë fosfolipide përbajtja e të cilave është zakonisht konstante ( 0.95 - 1,5% ). Përbajtja e lipideve në mish mundet të arrij deri në 10%.

**MATERIET MINERALE** - Mishi dhe organet e brendshme janë të pasura me materie minerale ( Na, Co, K, Mg, P, Cl, etj ). Sipas të dhënave Na në 100 g mish merr pjesë me 80 mg, Ca 400 mg, P 180 mg etj. Sa u përket mikroelementeve edhe ato janë prezente në mish si p.sh. Fe 2000 mikrogram në 100 g, Zn 5000mg në 100 g etj.

**VITAMINAT** – Mishi i qengjit është i pasur me vitamina sidomos vitaminën B-kompleks ku B1 ka 200 mg ( 100 g ) mish qengji. Në indin yndyror në sasira të vogla ka vitaminë A dhe D kurse vitamina C në këtë ind nuk është prezente.

## 2.6 Roli i kullosave dhe livadheve në mbarështimin ekstensiv(kullosor)

Bimët foragjere dhe kullotat sigurojnë themelin për bujqësinë e qëndrueshme. Foragjeret nga kullotat përdoren për të ushqyer bagëtitë dhe globalisht përfaqësojnë 26% të sipërfaqes së tokës dhe 70% të sipërfaqes bujqësore. Të lashtat foragjere përbëhen nga barërat bishtajore (Poaceae) dhe barishtore (Fabaceae) dhe disa familje të tjera botanike.

Zonat më të mëdha me kullota janë në malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, dhe Bjeshkët e Deçanit. Kullotat janë preferenciale ndaj burimeve të tjera të ushqimit të kafshëve, pasi kanë vlerë të lartë ushqyese, dhe shije të mirë, duke përmbushur kërkesat ushqyese të barngrënësve (bagëtitë, delet, dhitë, kuajt, etj.) Foragjeret e gjelbërta të freskëta kanë më shumë lagështi dhe kjo ndryshon në varësi të fazës së bimës dhe varion nga 60 në 80%.

Gjithashtu, lënda e thatë e marrë nga bimë të reja ka vlerë të lartë ushqyese, si dhe proteina mbi 20%, dhe shpesh sjell deri në 25% në lëndë të thatë. Livadhet (14%) dhe kullotat (30.2%) zënë pjesë të konsiderueshme të tokës në Kosovë dhe ato janë burim shumë i rëndësishëm i foragjereve për ushqimin e bagëtive dhe mbrojtjen e tokës nga erozioni. Bimët nga familja Poaceae janë bimët themelore foragjere që janë kryesisht në Kosovë.

Regjioni i Pejës mbulon sipërfaqen më të madhe me sipërfaqe Trifolium, ose 34% të sipërfaqeve totale 2084.50 ha e ndjekur nga rajoni i Prishtinës dhe Mitrovica.

Llojet më të rëndësishme të bimëve foragjere në Kosovë janë: jonxhë (*Medicago sativa* L.), tërfili i kuq (*Trifolium pratense* L.), tërfili i bardhë (*Trifolium repens* L.), thekra italiane (*Lolium multiflorum* L.), trefisha e këmbëve të shpendëve (*Lotus corniculatus* L.), fescue e kuqe (*Festuca rubra* L.), etj. Sipërfaqja prej 15010.77 ha në Kosovë kultivohet nga jonxha.

Sipërfaqja e livadheve, kullosave dhe tokës së përbashkët në vitin 2019 është 217 931.84 ha. Livadhet marrin pjesë me 70,679.04 ha (3.5t/ha), kullotat 5,135.04 ha dhe sipërfaqja e tokës së shfrytëzuar bujqësore me 142,117.75 ha. Sipërfaqja e tokës bujqësore, pjesa më e madhe u përket livadheve dhe kullosave duke e bërë Kosovën një vend ku ka mundësi të zhvillohet blegtoaria.



### 3. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Delja Autoktone e Sharrit është dele me prodhimtari të ulët dhe hynë në grupin e xhufkave.

Me përkrahje nga organizata qeveritare Turke për bashkëpunim dhe koordinim-TIKA e cila e mbështeti fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë,përkatësisht departamentin e Zooteknisë të cilët sollën nga gjermania desh të racës Virtemberg me qëllim të përmirësimit të xhufkave leshshkurtra vendore (Deles së Sharrit dhe Deles së Kosovës),peshore,mjete të tjera të nevojshme për ta përcjellur hulumtimin.

Me qëllim të rritjes së prodhimtarisë së mishit dhe cilësisë së leshit,delen e Sharrit(metis,gjenerata F1) e kemi kryqëzuar me merinosin Gjerman Virtembergun i cili ka potencial të mirë në shtimin e masës trupore dhe aftësinë të shtegtoj në terrene kodrinoro-malore dhe kjo ka bërë që ky kryqëzim me delen autoktone të Sharrit të jetë i suksesshëm duke kontribuar në rritjen e të ardhurave të fermerëve(nga shitja e tyre) dhe prodhimtari më të lartë të mishit.

Hulumtimi është kryer në fshatrat e komunës së Dragashit,i cili gjendet në pjesën jugore të Kosovës me reliev kodrinoro-malor dhe sipërfaqe prej 4500 ha(450 km<sup>2</sup>) ku 95% e kësaj sipërfaqe është park nacional dhe njihet si vendi ku kultivohet dhentaria më së shumti në Kosovë me numrin më të madh të deleve të mbarështuara.

Mbarështimi i të ushqyerit të deleve gjatë sezonit të verës(kur është kryer hulumtimi) ka qenë i formës ekstensive të lëshuar në kullotë(në bjeshkë) ndërsa dimrit në stallë.Si ushqim voluminoz gjatë sezonit të dimrit përdorën ushqime voluminoze(sanë dhe jonxhë) ndërsa si ushqime të koncentruara janë përdorur hime gruri dhe misri.



Qëllimi i këtij hulumtimi është:

- Dinamika e shtimit të masës trupore në periudhën pas mënzimit(3-6 muaj)të qengjave Sharr x Virtemberg,gjenerata F-2.
- Masa mesatare trupore e qengjave meshkuj,femra dhe binjakë (F2) në periudhën 90 ditë,120 ditë,150 ditë dhe 180 ditë.
- Vlerave të therrjes së qengjave meshkuj në 180 ditë,rrezën e mishit si dhe matjen e indeve dhe organeve veq e veq duke e përcaktuar peshën e tyre.
- Raporti në mes të indit muskolor,indit dhjamor dhe indit ashtor në qengjat e therrur.
- Krahasimi i masës trupore të qengjave F-2 me gjeneratën F-1 të hulumtuar nga autorë të tjerë.
- Të ushqyerit e qengjave gjatë periudhës së mbarështimit ekstensiv(kullosor).

## 4. MATERIALI DHE METODAT E PUNËS

### 4.1 Materiali

Si material për hulumtimet tona ka shërbyer kopeja e deleve Sharr x Virtemberg(F-1) të tre fermerëve,Emin kollani,Xhezahir kollani dhe Rrahim Kollani dhe kopeja e Shukri Myrtezanit në fshatin Zapllugjë të cilat u kryqëzuan me Merinosin Gjerman Virtembergun dhe dhanë gjeneratën F-2 të cilën e hulumtuam për shtim të masës trupore dhe kemi bërë krahasimin me gjeneratën F-1 të hulumtuar nga autorë të tjerë.Hulumtimi është realizuar duke përdorur peshorën digjitale por ka pas raste kur e kemi përdorur edhe peshoren mekanike(kur peshores digjitale i është harxhuar bateria).



Figura 11. Delet Sharr x Virtemberg(F-1)



Figura 12. Identifikimi i qengjit Sharr x Virtemberg(F-2)



**Figura 13. Peshorja digjitale**



**Figura 14. Matja me peshore mekanike**



**Figura 15. Matja e masës trupore të qengjit**



**Figura 16. Matja e përmasave trupore**



**Figura 17. Ekipi hulumtues në fermë  
(Grupi I)**



**Figura 18. Ekipi hulumtues në punën në terren  
(Grupi II)**

## 4.2 Metodatat e Punës

Në hulumtim si metodë e punës është përdorur peshorja me të cilën është bërë matja e qengjave metisë, gjenerata F-2 dhe janë përcjellur për 3 muaj pas fazës së mëmëzimit.

Në fillim të hulumtimit qengjat janë matrikuluar me qëllim të identifikimit më të lehtë të tyre dhe janë përcjellur 3 muaj pas ndarjes nga gjiu.

Te qengjat Sharr x Virtemberg gjenerata F-2 janë studiuar këta parametra:

- shtimi mesatar i masës trupore (dilor dhe mujor),
- vlera e karkasës,
- raporti i indeve të karkasës duke marrë kampionët për mostrim unaza e 11-të, unaza e 12-të dhe unaza e 13-të.

Për hulumtimin e shtimit të masës trupore janë hulumtuar 40 qengja prej të cilëve 15 të gjinisë mashkullore, 15 të gjinisë femërore dhe 10 binjakë (meshkuj dhe femra) të cilët janë përcjellë për 3 muaj prej periudhës së ndarjes nga gjiri.

Janë sakrifikuar 5 qengja për t'i parë raportin e indeve dhe rrezën e mishit. Therja është bërë me thikë nga kasapët ndërsa matja e organeve dhe indeve është bërë me peshore digjitale.

Rezultatet e fituara janë përpunuar me metoda statistikore.

## 5. REZULTATET

Për realizimin e hulumtimit të masës trupore e kemi përdorur peshoren digjitale dhe në disa raste edhe atë mekanike duke i matur qengjat në ditë të caktuara. Në hulumtim janë përfshirë qengja meshkuj, qengja femra dhe qengja binjakë (meshkuj dhe femra) të cilët masën trupore e kanë pasur të ndryshme.

**Tabela 1. Masa trupore e qengjave meshkuj Sharr x Virtemberg (F-2)**

	n	x	sd	Cv	Se	min	max
Masa trupore e qengjave meshkuj sharr x virtemberg F2(90 ditë)	15	26.57	0.81	3.1	0.21	24.8	27.6
Masa trupore e qengjave meshkuj sharr x virtemberg F2(120 ditë)	15	35.18	1.02	2.91	0.265065	32.7	36.3
Masa trupore e qengjave meshkuj sharr x virtemberg F2(150 ditë)	15	43.48	2.06	4.73	0.53242	40.2	47
Masa trupore e qengjave meshkuj sharr x virtemberg F2(180 ditë)	15	51.08	2.2	4.3	0.56	47.9	55.1

Në tabelën 1 janë paraqitur disa parametra statistikor të cilët erdhën në shprehje pas matjes së masës trupore të qengjave pas shkëputjes nga gjiri.


Qengjat pas ndarjes nga gjiri (90 ditë) kanë masë trupore mesatare 26.57 kg me vlerën më të lartë 27.6 kg, ndërsa vlera më e ulët 24.8 kg.

Qengjat në moshën 120 ditë kanë masë trupore mesatare 35.18 kg, me vlerën më të lartë 36.3 kg, ndërsa vlera më e ulët 32.7 kg. Shtimi mesatar mujor është 8.61 kg, ndërsa shtimi mesatar ditor është 0.287 gr.

Qengjat në moshën 150 ditë kanë masë trupore mesatare 43.48 kg, me vlerën më të lartë 47 kg, ndërsa vlera më e ulët 40.2 kg. Shtimi mesatar mujor është 8.3 kg, ndërsa shtimi mesatar ditor është 0.276 gr.

Qengjat në moshën 180 ditë kanë masë trupore mesatare 51.08 kg, me vlerën më të lartë 55.1 kg, ndërsa vlera më e ulët 47.9 kg. Shtimi mesatar mujor është 7.6 kg, ndërsa shtimi mesatar ditor është 0.253g.

Mesatarja e masës trupore dhe parametrat e llogaritur statistikor, të prezantuar në tabelë tregojnë se shumica e vlerave të masës trupore janë rreth mesatares.



**Grafiku 3. Masa trupore e qengjave meshkuj/kg**



**Grafiku 4. Shtimi ditor i qengjave meshkuj/gr**



Masa mesatare trupore e qengjave femra(F-2) në moshën 90,120,150 dhe 180 ditë është paraqitur në tabelën 2.

**Tabela 2.Masa trupore e qengjave femra (F-2)**

	n	X	Sd	Cv	Se	min	max
Masa trupore e qengjave femra sharr x virtemberg F2(90 ditë)	15	24.23	0.64	2.66	0.167	23.4	25.3
Masa trupore e qengjave femra sharr x virtemberg F2(120 ditë)	15	31.15	0.84	2.7	0.21	30.1	32.4
Masa trupore e qengjave femra sharr x virtemberg F2(150 ditë)	15	37.88	0.78	2.07	0.2	35.6	37.6
Masa trupore e qengjave femra sharr x virtemberg F2(180 ditë)	15	45.26	0.91	2	0.23	44.2	47.2


Qengjat femra pas ndarjes nga gjiri (90 ditë) kanë masë trupore mesatare 24.23 kg me vlerën më të lartë 25.3 kg,ndërsa vlera më e ulët 23.4 kg.

Qengjat femra në moshën 120 ditë kanë masë trupore mesatare 31.15 kg,me vlerën më të lartë 32.4 kg,ndërsa vlera më e ulët 30.1 kg.shtimi mesatar mujor është 6.92 kg,ndërsa shtimi mesatar ditor është 0.230 gr.


Qengjat femra në moshën 150 ditë kanë masë trupore mesatare 37.88 kg,me vlerën më të lartë 37.6 kg,ndërsa vlera më e ulët 35.6 kg.Shtimi mesatar mujor është 6.73 kg,ndërsa shtimi mesatar ditor është 0.224 gr

Qengjat femra në moshën 180 ditë kanë masë trupore mesatare 45.26 kg,me vlerën më të lartë 47.2 kg,ndërsa vlera më e ulët 44.2 kg.Shtimi mesatar mujor është 7.38 kg,ndërsa shtimi mesatar ditor është 0.246 gr.





**Grafiku 5. Masa trupore e qengjave femra(F-2)/kg**



**Grafiku 6. shtimi ditor i qengjave femra (F-2)/gr**

Masa mesatare trupore e qengjave binjakë në moshën 90,120,180 ditë është paraqitur në tabelën 3.

**Tabela 3.Masa trupore e qengjave binjakë (F-2)/kg**


	n	x	Sd	Cv	se	min	max
Masa trupore e qengjave binjakë sharr x virtemberg F2(90 ditë)	10	22.67	0.6	2.67	0.19	21.7	23.7
Masa trupore e qengjave binjakë sharr x virtemberg F2(120 ditë)	10	28.84	0.82	2.84	2.84	27.6	29.9
Masa trupore e qengjave binjakë sharr x virtemberg F2(150 ditë)	10	34.88	0.62	1.78	0.19	33.6	35.6
Masa trupore e qengjave binjakë sharr x virtemberg F2(180 ditë)	10	41.54	0.76	1.83	0.24	40	42.4

Qengjat binjakë (F-2) pas ndarjes nga gjiri (90 ditë) kanë masë trupore mesatare 22.67 kg me vlerën më të lartë 23.7 kg,ndërsa vlera më e ulët 21.7 kg.


Qengjat binjakë (F-2) në moshën 120 ditë kanë masë trupore mesatare 28.84 kg,me vlerën më të lartë 29.9 kg,ndërsa vlera më e ulët 27.6 kg.shtimi mujor i masës trupore është 6.17 kg ndërsa shtimi ditor është 0.205 gr

Qengjat binjakë (F-2)në moshën 150 ditë kanë masë trupore mesatare 34.88 kg,me vlerën më të lartë 35.6 kg,ndërsa vlera më e ulët 33.6 kg.Shtimi mujor i masës trupore është 6.04 kg ndërsa shtimi ditor është 0.201 gr.

Qengjat binjakë (F-2) në moshën 180 ditë kanë masë trupore mesatare 41.54 kg,me vlerën më të lartë 42.4 kg, ndërsa vlera më e ulët 40 kg.Shtimi mesatar mujor është 6.66 kg ndërsa shtimi ditor është 0,222 gr.



**Grafiku 7. Masa trupore e qengjave binjakë(F-2)/kg**



**Grafiku 8. Shtimi ditor i qengjave binjakë (F-2)/gr**

Vlerat e therrjes janë hulumtuar në 5 qengja të gjinisë mashkullore. Qengjat janë therur në moshën 180 ditëshe dhe në bazë të tyre janë hulumtuar rezultatet e prodhimit të mishit të metisëve Sharr x Virtemberg, gjenerata F-2.



**Figura 19. Deponimi i gjakut në kovë**



**Figura 20. Rrjepja e qengjit**



**Figura 21. Pastrimi i organeve**



**Figura 22. Pastrimi i zorrëve pas therrjes**

### 5.1 Rezultatet e therrjes së qengjave

Të dhënat për masën e gjallë trupore dhe vlerat e organeve në trupin e ftohtë janë paraqitur në tabelën 4.

**Tabela 4. Vlerat e therrjes së qengjave meshkuj në trupin e ftohtë**

Nr		n	x	Sd
1	Masa e gjallë para therrjes	5	50	1.58
2	Lëkura	5	9.4	0.36
3	Këmbët	5	1.92	0.07
4	Zorrët e holla	5	1.4	0.079
5	Zorrët e trasha	5	1.246	0.10
6	Lukthi	5	1.238	0.042
7	Gjaku	5	2.316	0.07
8	Koka	5	2.496	0.073
9	Mëlqia	5	0.96	0.031
10	Mushkëritë	5	0.908	0.037
11	Veshkat	5	0.377	0.041
12	Masa e trupit pa organe dhe kokë	5	27.737	0.84
13	karkasa %	5	55.47	


Në tabelën 4 janë paraqitur vlerat e therrjes të qengjave meshkuj ( $n=5$ ) në ditën e therrjes (180 ditë) të cilët kanë masë mesatare trupore 50 kg. Lëkura peshon 9.4 kg (8.8% në raport me masën e gjallë të qengjave). Këmbët e meshkujve kanë peshë mesatare 1.92 kg (3.84% në raport me masën e gjallë të qengjave). Zorrët e holla peshojnë 1.4 kg (2.8% në raport me masën e gjallë trupore). Zorrët e trasha peshojnë 1.24 kg (2.48% në raport me masën e gjallë të qengjave). Lukthi peshon 1.23 kg (2.46% në raport me masën e gjallë trupore). Gjaku peshon 2.31 kg (4.62% në raport me masën e gjallë trupore). Koka peshon 2.49 kg (4.98% në raport me masën e gjallë). Mëlqia peshon 0.96 kg (1.92% në raport me masën e gjallë). Mushkëritë peshojnë 0.9 kg (1.8% në raport me masën e gjallë). Veshkët peshojnë 0.377 kg (0.75% në raport me masën e gjallë). Masa e trupit pa organe dhe kokë peshon 27.73 kg (55.46% në raport me masën e gjallë).

Në tabelën 5 është paraqitur raporti në mes indit muskolor,dhjamor dhe ashtor tek qengjat e therur(n=5) meshkuj Sharr x Virtemberg (F-2).

**Tabela 5.Përmbajtja mesatare e indit muskolor(mishit),indit yndror(dhjamit) dhe indit ashtor në mishin e qengjave meshkuj Sharr x Virtemberg (F-2)**

Gjinia	n	Masa e kampionit, gr	Indi muskolor,gr	indi muskolor%	indi dhjamor,gr	indi dhjamor %	indi ashtor,gr	indi ashtor %
Meshkuj	5	146.4	69.8	47.66	30	20.43	46.6	31.89

Tek qengjat meshkuj (n=5)në kampionët e analizuar ,indi muskolor merr pjesë me mesataren 47.66%,indi dhjamor mesatarja 20.43% dhe indi ashtor mesatarja 31.89%.



**Grafiku 9. Masa e indeve/gr**

## 6. DISKUTIMET

Dhentaria në Kosovë përbëhet nga 4 lloje të deleve autoktone(xhufkave) të cilat janë:delja e Sharrit e kryqëzuar(metisë),delja e Kosovës,delja Bardhoka dhe delja Balusha.

Delja e Sharrit është dele me prodhimtari të ulët të qumështit,mishit,leshit dhe kështu e kemi kryqëzuar me dashin e racës Virtemberg(me drejtim të prodhimit mish-lesh) i cili ka bërë që qengjat Sharr x Virtemberg(metisë) të kenë prodhimtari më të lartë të mishit dhe lesh më cilësor.

Hulumtimi im është përqendruar në përcjelljen e shtimit të masës trupore të qengjave Sharr x Virtemberg gjenerata F-2 pas fazës së mëmëzimit(3-6 muaj) dhe krahasimin me qengjat F-1 të hulumtuar nga autorë të tjerë.

Qengjat meshkuj(F-2) në moshën 90 ditë kanë masë mesatare trupore 26.57 kg të cilët në krahasim me qengjat meshkuj(F-1) kanë 2.74 kg masë më të lartë trupore.

Qengjat meshkuj(F-2) në moshën 120 ditë kanë masë mesatare trupore 35.18 kg të cilët në krahasim me qengjat binjakë F-1 kanë 3.61 kg masë më të lartë trupore.

Qengjat meshkuj (F-2) në moshën 150 ditë kanë masë mesatare trupore 43.48 kg,të cilët në krahasim me qengjat binjakë F-1 kanë 3.23 kg masë më të lartë trupore.

Qengjat meshkuj F-2 në moshën 180 ditë kanë masë mesatare trupore 51.08 kg të cilët në bazë të trendit të rritjes mund të kenë 3.63 kg masë më të lartë trupore në krahasim me qengjat meshkuj F-1.

Qengjat femra (F-2) në moshën 90 ditë kanë masë mesatare trupore 24.23 kg të cilët në krahasim me qengjat femra(F-1) kanë 2.5 kg masë më të lartë trupore.

Qengjat femra(F-2) në moshën 120 ditë kanë masë mesatare trupore 27.9 kg të cilët në krahasim me qengjat F-1 kanë 3.25 kg masë më të lartë trupore.

Qengjat femra (F-2) në moshën 150 ditë kanë masë mesatare trupore 43.48 kg, të cilët në krahasim me qengjat e F-1 kanë 3.23 kg masë më të lartë trupore.

Qengjat femra F-2 në moshën 180 ditë kanë masë mesatare trupore 45.26 kg të cilët në bazë të trendit të rritjes mund të kenë 3.26 kg masë më të lartë trupore në krahasim me qengjat femra F-1.

Qengjat binjakë (F-2) në moshën 90 ditë kanë masë mesatare trupore 22.67 kg të cilët në krahasim me qengjat binjakë(F-1) kanë 3.58 kg masë më të lartë trupore.

Qengjat binjakë (F-2) në moshën 120 ditë kanë masë mesatare trupore 28.84 kg të cilët në krahasim me qengjat binjakë F-1 kanë 6.24 kg masë më të lartë trupore.

Qengjat binjakë (F-2) në moshën 150 ditë kanë masë mesatare trupore 34.88 kg, të cilët në krahasim me qengjat binjakë F-1 kanë 1.34 kg masë më të lartë trupore.

Qengjat binjakë F-2 në moshën 180 ditë kanë masë mesatare trupore 41.54 kg të cilët në krahasim me qengjat binjakë F-1 mund të kenë 2.54 kg masë trupore më të lartë.



## 7. PËRFUNDIMET

Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimeve, qëllimi i të cilave ka qenë që të hulumtohet masa trupore e qengjave Sharr x Virtemberg(F-2) pas fazës së mëmëzimit(3-6 muaj), vlera e karkasës ku janë peshuar organet dhe indet e kafshëve të therura dhe është gjetur raporti në mes të indit muskolor, indit dhjamor, indit ashtëror. Masën trupore të qengjave F-2 të përcjellur në hulumtim e kemi krahasuar me masën trupore të qengjave F1 të marrur nga hulumtimet tjera në mënyrë që të japim më lehtë konkluzione.

Në këtë hulumtim mund të japim këto përfundime:

Merinosi gjerman Virtembergu ka treguar rezultate të kryqëzimit me delen tonë autoktone Delen e Sharrit dhe nga ky kryqëzim qengjat Sharr x Virtemberg (F1 dhe F2) janë metisë me drejtim të prodhimit mish-lesh të cilët kanë interes ekonomik për mbarëshitim në Kosovë nga ana e fermerëve;

Qengjat meshkuj F2 në moshën 90 ditë(pas shkëputjes nga gjiu) kanë masë mesatare trupore 26.56 kg;

Qengjat meshkuj F2 në moshën 120 ditë kanë masë mesatare trupore 35.18 kg ndërsa shtimin ditor mesatar e kanë 0.287 gr;

Qengjat meshkuj F-2 në moshën 150 ditë kanë masë mesatare trupore 43.48 kg ndërsa shtimin ditor ditor mesatar e kanë 0.276 gr ;

Qengjat meshkuj F-2 në moshën 180 ditë kanë masë mesatare trupore 51.08 kg, shtim ditor mesatar 0.253 gr;

Qengjat femra F-2 në moshën 90 ditë(pas shkëputjes nga gjiu) kanë masë mesatare trupore 24.23 kg;

Qengjat femra F-2 në moshën 120 ditë kanë masë trupore mesatare 31.15 kg ndërsa shtimi ditor mesatar është 0.230 gr;

Qengjat femra F-2 në moshën 150 ditë kanë masë trupore mesatare 37.88 kg, ndërsa shtimi ditor mesatar është 0.224 gr;

Qengjat femra F-2 në moshën 180 ditë kanë masë mesatare trupore 45.26 kg, shtim ditor mesatar 0.246 gr;

Qengjat binjakë F-2 në moshën 90 ditë (pas shkëputjes nga gjiri) kanë masë mesatare trupore 22.67 kg;

Qengjat binjakë F-2 në moshën 120 ditë kanë masë mesatare trupore 28.84 kg ndërsa shtimi ditor mesatar është 0.230 gr;

Qengjat binjakë F-2 në moshën 150 ditë kanë masë mesatare trupore 34.88 kg ndërsa shtimi ditor mesatar është 0.201 gr;

Qengjat binjakë F-2 në moshën 180 ditë kanë masë mesatare trupore 41.54 kg ndërsa shtimi ditor mesatar është 0.222 gr;

Karkasa e qengjave të therur në trup të nxehtë ka vlerën mesatare 55.47%;

Te qengjat meshkuj, në kampionët e analizuar, indi muskolor merr pjesë me 47.66%, indi dhjamor 20.43% dhe indi ashtor 31.89%.

Tek qengjat meshkuj të therrur në moshën 180 ditësh lëkura ka masë mesatare 9.4 kg, këmbët kanë masë mesatare 1.92 kg, Zorrët e holla kanë masë mesatare 1.4 kg, Zorrët e trasha kanë masë mesatare 1.24 kg, Lukthi ka masë mesatare 1.24 kg, Gjaku ka masë mesatare 2.31 kg, Koka ka masë mesatare 2.49 kg, Mëlqia ka masë mesatare 0.96 kg, Mushkëritë kanë masë mesatare 0.908 kg, Veshkat kanë masë mesatare 0.377 kg.

Qengjat meshkuj treguan potencial më të lartë gjenetik të shtimit të masës trupore në krahasim me qengjat femra dhe binjakë.

Qengjat meshkuj, femra dhe binjakë të gjeneratës F-2 në kushte të njejta të mbarështimit (mbarështim ekstensiv) treguan shtim më të lartë të masës trupore në periudhën pas mëmëzimit në krahasim me F-1.

## 8. REFERENCAT

- 1.(Fajardo et al., 2016)Animales, G., & Animales, G. (2014). Editorial. *Animal Genetic Resources/Ressources Génétiques Animales/Recursos Genéticos Animales*, 54, i. <https://doi.org/10.1017/s2078633614000186>
- Fajardo, S., García-Galvan, R., F., Barranco, V., Galvan, J. C., & Batlle, S. F. (2016). We are IntechOpen , the world ' s leading publisher of Open Access books Built by scientists , for scientists TOP 1 %. *Intech, i(tourism)*, 13.
- 2.(Animales & Animales, 2014)Animales, G., & Animales, G. (2014). Editorial. *Animal Genetic Resources/Ressources Génétiques Animales/Recursos Genéticos Animales*, 54, i.
- 3.(Font i Furnols et al., 2009)Font i Furnols, M., Realini, C. E., Guerrero, L., Oliver, M. A., Sañudo, C., Campo, M. M., ... Montossi, F. (2009). Acceptability of lamb fed on pasture, concentrate or combinations of both systems by European consumers. *Meat Science*, 81(1), 196–202.
4. (Warner, Greenwood, Pethick, & Ferguson, 2010)Warner, R. D., Greenwood, P. L., Pethick, D. W., & Ferguson, D. M. (2010). Genetic and environmental effects on meat quality. *Meat Science*, 86(1), 171–183.
5. (Ruzic-Muslic et al., 2012)Ruzic-Muslic, D., Petrovic, M. P., Petrovic, M. M., Bijelic, Z., Pantelic, V., Perisic, P., & Caro-Petrovic, V. (2012). The effect of crossing on meat yield and quality of weaned lambs. *Biotechnology in Animal HusbandryBiotehnologija u Stocarstvu*, 28(4), 751–758.
6. (Fogarty et al., 2007)Fogarty, N. M., Ingham, V. M., Gilmour, A. R., Afolayan, R. A., Cummins, L. J., Edwards, J. E. H., & Gaunt, G. M. (2007). Genetic evaluation of crossbred lamb production. 5. Age of puberty and lambing performance of yearling crossbred ewes. *Australian Journal of Agricultural Research*, 58(9), 928–934.
7. (Endo et al., 2012)Endo, V., Sobrinho, A. G. S., Lima, N. L. L., Manzi, G. M., Cirne, L. G. A., Santana, V. T., & Almeida, F. A. (2012). Muscularity and Leg Tissue Composition of Lambs Fed with Hydrolyzed Sugarcane. (January 2012), 1165–1167

8. (Farrell & Hopkins, 2007)Farrell, T. C., & Hopkins, D. L. (2007). A hedonic model of lamb carcass attributes. (May 2014).
9. (Beriaian, Purroy, Treacher, & Bas, 2000)Beriaian, M. J., Purroy, A., Treacher, T., & Bas, P. (2000). Effect of animal and nutritional factors and nutrition on lamb meat quality. *Cahiers Options Méditerranéennes*, 52, 75–86. Retrieved from
10. (Petrovic et al., 2015)Petrovic, M. P., Petrovic, C., Ruzic-Muslic, D., Maksimovic, N., Petrovic, M. M., Ilic, Z., & Stojkovic, J. (2015). Effect of genetic and environmental factors on the phenotype characteristics of lambs. *Biotechnology in Animal Husbandry*Biotehnologija u Stocarstvu, 31(2), 223–233.
11. Statistikor, V. (2019). Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2019.
12. [http://www.fao.org/ag/againfo/themes/en/meat/backgr\\_sources.html](http://www.fao.org/ag/againfo/themes/en/meat/backgr_sources.html)
13. <https://kosovo-mining.org/kosova/kushtet-klimatike/>
- 14.XIII International Symposium biodiversity and Sustainable Development Tirana,14 Dec,2018
- Formati trupor dhe masa e gjallë e deshve Virtmberg të importuar në Kosovë
15. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/11/blegtoria-e-vecante-final-01-korrik-2013.pdf>
16. <https://www.alamy.com/stock-photo/wurttemberg-sheep.html>
- 17.<https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anketa-e-ekonomive-bujqesore-2018>
- 18.<https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anketa-e-ekonomive-bujqesore-aeb-2019>
- 19.Mehmeti H.,Simijonovic.V.1985.Prodhimi dhe cilësia e leshit tek delja e Sharrit dhe e Virtembergut dhe melezet e tyre te gjeneratës F-1 .Stocarstvo,5-6,195-205.Zagreb.
- 20.Mehmeti H.Profili viziv gjenetik si dhe parametrat dhe korrelacionet e treguesve fenotipik sasior dhe cilësor të racës Bardhokë.(Disertacion i Doktoranturës).Tiranë.2000.

21. Identification and Conservation of Animal Genetic resources in South eastern Europe, May, 2006, Skopje.
22. <https://ask.rks-gov.net/media/1374/rezultatet-perfundimtare.pdf>
23. PUNIM MASTER A.ZOGAJ-Parametrat prodhues dhe riprodhues të metisëve Sharr x Virtemberg gjenerata F-1.